



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dërguar Priljeno / Prigatito Received / Delivery	27.10.2023	3	viii god veçr
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSH/CR	6727/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1158/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1158/2023 të datës 13.09.2023 të ankuesit [redacted] me adresë banimi: Rruga "Fehmi Agani" Komuna e Gjakovës, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1158/2023 e datës 13.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Anulohet Njoftimi i datës 01.09.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. Detyrohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të ndërmarrë veprimet juridike për përfshirjen e ankuesit në listën e ngushtë për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm" i Institutit të Kosovës për Administratë Publike.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsy e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 20.07.2023 ka shpallur konkursin për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm" i Institutit të Kosovës për Administratë Publike, në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi _____ e cili për shkak të pakënaqësive me procedurën e zhvilluar të rekrutimit, gjegjësisht me mos përfshirjen në listën e ngushtë në kuadër të fazës së verifikimit paraprak, me datë 13.09.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net kishte parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në është regjistruar nën shenjën A.nr.11585/2023 dhe numër protokoli:6075/2023

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Departamenti për Menaxhimin Zyrtarëve Publik me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses ka shkelur dispozitat e ligjit material, ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike pasi që i njëjta pretendon se posedon dëshmi/diplomë të studimeve 5 vjeçare (3+2) dhe se mbi bazën e të njëjtave kualifikimi Departamenti për menaxhimin e Zyrtarëve Publik në të kaluarën e ka përfshirën në listën e ngushtë në konkursin për pozitën: Drejtor Ekzekutim, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (RN00009664); Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës (RN00008914) ku në të dy rastet kriteret e konkurseve janë të njëjtat me ato të konkursit të datës 20.07.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 15.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme me datë 22.08.2023 ka dërguar përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj lëndë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli: 6075/2023 e datës 13.09.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 13.09.2023 dërguar nga ankuesi në Këshill; Konkursin e datës 20.07.2023; Njoftimin e datës 01.09.2023; Kërkesën e ankuesit të datës 05.09.2023; E-mailin e datës 12.09.2023 dërguar nga I.P për ankuesin; Konkursin e datës 04.08.2023; Njoftimin e datës 20.09.2023; Konkursin e datës 28.04.2022; Njoftimin e datës 14.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.09.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 26.09.2023; Vendimin e datës 30.04.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 28.04.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 07.06.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Listën e kandidatëve; Aplikacionin e ankuesit të datës 21.08.2023 me të gjitha dosjen e bashkangjitur të aplikimit; Diplomën e datës 16.07.2018 me numër:1686; Diplomën e datës 24.10.2016 me numër:46/16; Letër reference e datës 25.12.2017; Vërtetimin e datës 09.07.2013; Referencën e datës 14.09.2011; Vërtetimin e datës 11.10.2021; Vërtetimin e datës 03.07.2020; Vërtetimin e datës 21.08.2023; Pasqyrën e llogarisë-Trusti të datës 15.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme përmes njoftimit të datës 20.07.2023 ka shpallur konkursin-pranim për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm" i Institutit të Kosovës për Administratë Publike me shifër reference RN00012129, me kriteret e përcaktuara si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 4 vite të studimeve në drejtimet: Menaxhment publik, shkencë politike/administratë publike, drejtësi dhe ekonomi;*
- *Kualifikime të posaçme formale: nuk ka kërkesa të posaçme formale për këtë pozitë;*
- *Përvoja e punës së kërkuar: Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Nga shkresat e administruara të lëndës, konstatohet fakti se ankuesi sipas aplikacionit të datës 21.08.2023 ka aplikuar në këtë procedurë brenda afatit të përcaktuar kohor, ndërsa i njëjti përmes e-mailit të datës 01.09.2023 është njoftuar nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik se nuk ka hyrë në listën e ngushtë me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi: *Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 4 vite të studimeve në drejtimet: Menaxhment publik, shkencë politike/administratë publike, drejtësi dhe ekonomi, ashtu siç ishte kërkuar në konkurs.* Tutje, ankuesi me datë 05.09.2023 i është drejtuar me kërkesë për sqarime shtesë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa përmes e-mailit të datës 12.09.2023 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ankuesi është njoftuar se aplikacioni i tij është verifikuar përsëri dhe se i njëjti është refuzuar për shkaqet e dhëna sikurse në arsyetimin e njoftimit të datës 01.09.2023 me këshillën dhënë juridike se i njëjti mund të parashtrijë ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit prej tetë (8) ditësh.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar aplikacionin e ankuesit të datës 21.08.2023 me shifër të shpalljes RN00012129 me shkresat e bashkangjitura të ofruara në cilësi të provave materiale nga ana e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe ka gjetur se ankuesi posedon Diplomën e datës 16.07.2018 me numër:1686 sipas së cilës dëshmohet se i njëjti me datë 17.12.2007 ka mbaruar studimet në Fakultetin e Shkencave Aplikative të Biznesit në Pejë në kuadër të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina dhe ka marrë titullin Bachelori i Shkencave të Aplikuara në Biznes, po ashtu i njëjti posedon Diplomën e datës 24.10.2016 sipas së cilës dëshmohet se i njëjti me datë 28.06.2013 ka mbaruar studimet në Kolegjin Biznesi-Programi Menaxhment dhe Financa dhe ka marrë titullin Master i Arteve në Menaxhment dhe Financa, ndërsa edhe sipas Vërtetimit të punës së datës 21.08.2023 lëshuara nga Komuna e Gjakovës dëshmohet se i njëjti që nga data 16.04.2018 ka qenë i emëruar në pozitën e punës Menaxher i Burimeve Njerëzore të cilën vazhdon të mbajë, kurse ndërmjet kësaj periudhe kohore, pra nga data 16.04.2018 deri me datë 21.08.2023 (sipas Vërtetimit të datës 03.07.2020 i njëjti ka qenë i emëruar Kryesues i Bordit të Drejtorëve në KRM "Çabrat" nga data 22 janar 2020 deri me datë 30 qershor 2020, kurse sipas Vërtetimit të datës 11.10.2021 të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dëshmohet se i njëjti nga data 19.06.2020 e deri me datë 22.03.2021 ka qenë i emëruar Zëvendës Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve) nga rrjedh se gjatë periudhës së referuar kohore si më lartë, ankuesi ka pasur 5 vite e 4 muaj përvojë pune menaxheriale, po ashtu sipas referencës së datës 14.09.2011 dëshmohet se ankuesi nga data 10.07.2008 deri me datë 31.08.2011 ka mbajtur pozitën e punës Menaxher i Hotelit "NORA"; sikurse edhe sipas Vërtetimit të datës 09.07.2023

dëshmohej se ankuesi gjatë viteve ka ushtruar mandatin 4 vjeçar në cilësi të Anëtarit të Kuvendit Komunal të Gjakovës, dhe po ashtu sipas letër referencës së datës 25.12.2017 dëshmohej se i njëjti në periudhën kohore maj 2014 deri në dhjetor 2017 ka mbajtur pozitën Menaxher Regional-Regjioni i Pejës në kuadër të Kompanisë së Sigurimeve Besa Security, andaj duke marrë për bazë dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil-Shtojca Nr.1/2: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Lartë 2 sipas së cilës përcaktohen qartë kërkesat e përgjithshme formale, sikurse në vijim: *"a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese"* si dhe kriteret e shpallura të konkursit të datës 20.07.2023 konstatohet fakti se ankuesi ka plotësuar kriteret e konkursit përkitazi me përcaktimin e dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil-Shtojca Nr.1/2: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Lartë 2, prandaj njoftimi i datës 01.09.2023 për mos përfshirjen e ankuesit në listën e ngushtë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material si pasojë e konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, ngase ankuesi ka përfunduar studimet universitare sipas sistemit (3+2) e cila dëshmohej përmes dy (2) diploma nga dosja e ankuesit dhe se i njëjti ka më shumë se 4 vite të studimeve, sikurse në vërtetimet e dëshmuara për përvojën e punës i njëjti ka më shumë se tetë (8) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave më shumë se pesë (5) vite përvojë menaxheriale, sikurse përcaktohet edhe me nenin 18 paragrafi 3 të së njëjtës rregullore: *"18.3. Përvoja profesionale dhe/apo menaxheriale llogaritet pas diplomimit në ciklin e parë të studimeve themelore"*, përvojë kjo e cila dëshmohej dhe përputhet me të dhënat e lartcekura edhe sipas pasqyrës së llogarisë së Kursimeve Pensionale-Trusti të datës 15.08.2023.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të dispozitave të nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se *"Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: 1.1. vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ,"* ndërlidhur me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.4 dhe 1.5 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material"* ka ardhur në përfundimin se Njoftimi i datës 01.09.2023 si dhe shkresat e përcjella përmes e-mailit të datës 01.09.2023 dhe atij të datës 12.09.2023 përmes të cilave ankuesit i është bërë i njohur fakti se i njëjti nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, janë akte administrative të paligjshme, ngase të njëjtat në asnjë pjesë të përmbajtjes së arsytimit të tyre nuk iu referohen se cilat kriteret në mënyrë specifike nuk i ka plotësuar ankuesi, madje arsytimi i të njëjtave shkresa nuk përcakton se mbi cilën bazë të dispozitave ligjore të ligjit material, Rregullores Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nën-punësve të Lartë Drejtues apo të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, janë bazuar me rastin e refuzimit të aplikacionit të datës 21.08.2023, nga rrjedh se arsytimi i dhënë ndaj ankuesit është i pamjaftueshëm, apo i barabartë me mungesën e tij e që është shkelje në vete përveç shkeljeve të lartcekura, ngase për palën në procedurë akti që njeh po cenon të drejtat e tij duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i mbështetur në dispozitat të aplikuara ligjore.

Nga se u tha si më lartë, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë në këtë procedurë të rekrutimit sipas konkursit të datës 20.07.2023 me shifër RN00012129, dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka vendosur të anulojë Njoftimin e datës 01.09.2023 me përbërjen e listës së ngushtë të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve, ndërsa Departamenti për Menaxhimin Zyrtarëve Publik obligohet që ankuesin ta përfshijë në listën e ngushtë për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm" i Institutit të Kosovës për Administratë Publike, duke marrë për bazë pikëpamjet juridike të këtij vendimi, ngase ankesa e ankuesit është e bazuar në ligjin material, prandaj u vendos sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1158/2023

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së